



Më shumë mbështetje për fermerët - Kreu i Këshillit të Agrobiznesit: Eksportet janë rritur, bujqësia ka nevojë për para shtesë

Faqe 2

Kombet e Bashkuara nisin një program ambicioz mbi transformimin digjital dhe të qëndrueshëm të bujqësisë në Shqipëri

Faqe 2

Gonxhja: Përmirësim i aksesit në financë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Faqe 4



AGROBIZNESI

FED invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit nëntor 2024

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 497

Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

PROGRAMI GLOBAL PËR CILËSINË DHE STANDARDET, ZBATUAR NGA UNIDO DHE FINANCUAR NGA SECO

GJURMUESHMËRIA DHE BUIQËSIA ORGANIKE, TRAJNIMET QË FUQIZOJNË FERMERËT, NVM-TË, QTTB-TË DHE AREB-TË NË SHKODËR DHE KORÇË

UNIDO organizoi trajnime gjithëpërfshirëse tre-ditore në Shkodër dhe Korçë për të adresuar sfidat kryesore në sektorin bujqësor shqiptar me fokus bimët aromatike dhe medicinale. Fokusi kryesor ishte pajisja e pjesëmarrësve me njohuri dhe aftësi mbi gjurmueshmërinë dhe certifikimin organik, duke ndihmuar ata të përmbushin standardet ndërkombëtare dhe të përshtaten me ndryshimet e fundit ligjore dhe rregullatore

GO SP ALBANIA
GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Denaj prezanton p.buxhetin 2025 në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin: 15 miliardë lekë për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Faqe 4

ÇMIMET

Abuzimi me çmimet në tregun e grumbullimit të fruta-perimeve, Konkurrenca hetim në 5 qarqe

Faqe 6

NGROHJA GLOBALE

Buxheti i shtetit 2025 dhe kërcënimet nga ngrohja globale e klimës

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Faqe 10

TEMA TË DITËS

- Projekt pilot - Ndryshojnë njësitet e tregtimit të fruta-perimeve/ Agjencia hap tenderin për tezgat e reja në tregjet e Tiranës Fq.4
- Si po transformohet industria e bimëve mjekësore? - Mungesa e fuqisë punëtore/ Nga "gjurmimi" në male tek kultivimi total Fq.5
- FSHZH, "megaprojekt" për rigjenerimin e fshatrave të Shqipërisë - Rikualifikim urban dhe sistemim rrugësh për 4 rajonet e vendit Fq.5
- Denaj ndan historinë e fermerit në Tropojë, eksporton 50 ton gështenja Fq.5
- Shqipëria merr pjesë për herë të parë në Panairin e Ushqimit në SHBA organizuar nga AIDA Fq.6

SIGURI USHQIMORE

Gripi i shpendëve, MBZHR ndalon importet nga 17 shtete evropiane

Faqe 4

TEMA TË DITËS

Kombet e Bashkuara nisin një program ambicioz mbi transformimin digjital dhe të qëndrueshëm të bujqësisë në Shqipëri



Shqipëria dhe Kombet e Bashkuara nisen një program të përbashkët risi që kontribuon në digjitalizimin e bujqësisë për të çuar përpara objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm me mbështetje dhe incentiva sistematike që synojnë veçanërisht fermerët e vegjël.

“Bujqësia Digjitale dhe Transformimi Rural” (DART) është një program trevjeçar (2024-2027) i financuar nga Thirrja për Transformimin Digjital të Joint SDG Fund me një buxhet total prej 3.3 milionë USD, që synon të arrijë objektivat e tij duke zhvilluar një strategji kombëtare digjitale të bujqësisë dhe një plan veprimi në përputhje me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian. Programi ka si synim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike digjitale përmes Portalit të Fermerëve Shqiptar, duke zhvilluar kapacitete digjitale midis fermerëve të vegjël, studentëve, shkollave dhe qendrave të formimit tekniko-profesionale dhe kualifikimeve, si dhe punonjësve të sektorit publik.

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) udhëheq zbatimin e nismës në bashkëpunim me partnerët e saj, Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), si dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj,

theksoi se DART do të luajë një rol kritik në mbështetjen e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, duke përmirësuar përputhjen me standardet dhe rregulloret e BE-së, veçanërisht në bujqësi dhe zhvillimin rural. Ajo theksoi se DART është plotësisht në përputhje me strategjitë kombëtare të Shqipërisë, si Strategjia Kombëtare për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027, Axhendën Digjitale 2022-2026 dhe Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore. Ministrja Denaj vuri në dukje se digjitalizimi në bujqësi nuk ka të bëjë vetëm me teknologjinë; ka të bëjë me ndryshimin sistematik. “Përmes DART, ne synojmë të përdorim mjetet digjitale si katalizatorë për të rritur transparencën, për të përmirësuar efikasitetin e prodhimit, për të mbështetur pajtueshmërinë rregullatore dhe për të kursyer kostot në të gjithë sektorin bujqësor,” – tha ajo.

Fiona McCluney, Koordinator e Përhershme e OKB-së në Shqipëri, theksoi se nisma ka një rëndësi të madhe për të ardhmen bujqësore të Shqipërisë dhe ambiciet më të gjera të Kombeve të Bashkuara. “Ky bashkëpunim është pikërisht veprimi largpamës i synuar kur Shtetet Anëtare miratuan Paktin për të Ardhmen në shtator të këtij viti. Duke inkurajuar inovacionin dhe duke përdorur teknologjinë, programi DART do të demonstrojë se si përpjekjet e përbashkëta mund të japin rezultate në terren për njerëzit vulnerabel.”


McCluney vlerësoi bashkëpunimin konstruktiv midis agjencive të OKB-së në Shqipëri me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Shqipërisë, BE-në, Suedinë dhe Spanjën si kontribues në Joint SDG Fund.

Hubert Perr, Drejtuesi i Bashkëpunimit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, tha se BE është e lumtur të mbështesë këtë projekt, i cili përputhet në mënyrë të përkryer me objektivat e synimeve të OKB-së për zhvillimin e qëndrueshëm dhe me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE në sektorin e bujqësisë. “BE e ka njohur shumë kohë më parë rëndësinë e digjitalizimit, duke pranuar se kërkimi, inovacioni dhe teknologjitë mund të ndihmojnë bujqësinë në adresimin e sfidave kryesore, si sigurimi i ushqimit të mjaftueshëm duke garantuar qëndrueshmërinë e prodhimit. Digjitalizimi gjithashtu i mundëson administratës të ofrojë mbështetje të shpejtë dhe efikase për sektorin e bujqësisë. Teknologjitë e reja të praktikave bujqësore rrisin produktivitetin dhe konkurrencën në tregjet botërore dhe u mundësojnë prodhuesve të bëhen më elastikë në kohën e ndryshimeve klimatike. Digjitalizimi është një mjet thelbësor për të kursyer burimet e pakta të forcës punëtore, dhe për të reduktuar gjurmën ekologjike, në përputhje me Axhendën e Gjellbër të BE-së për Ballkanin Perëndimor.”



Më shumë mbështetje për fermerët - Kreu i Këshillit të Agrobiznesit: Eksportet janë rritur, bujqësia ka nevojë për para shtesë

Rreth 15 miliardë lekë do të jetë mbështetja nga buxheti për bujqësinë vitin që vjen



Ministrja e Bujqësisë, Anila Denaj prezantoi projektligjin në Komisionin e Veprimtarive ndërsa tha se në vëmendje do të jenë investimet për mbrojtjen nga përmbytjet dhe më shumë mbështetje direkte për fermerët. Aktualisht për skemën

marrë parasysh potencialet e tij. Ai theksoi se bazuar në disa analiza dhe projeksione, sektori të bujqësisë aktualisht i duhen dhe 95 milionë euro të tjera shtesë, që të bëhet konkurruese me vendet e rajonit.

bujqësisë I nevojiten edhe 95 milionë euro të tjera, në mënyrë që të krahasohet me konkurrentët e vendeve të rajonit, sepse me vendet e BE nuk krahasohemi dot”, u shpreh ai.


Ai theksoi se duhen më shumë fonde dhe një shpërndarje aty ku është nevoja më e madhe.

“Duhet një shpërndarje më e mirë. Kam vërejtje për sasinë e buxhetit”, tha ai.

Gjatë diskutimit në studio, Rrapaj tha se vitet e fundit janë shtuar eksportet e produkteve shqiptare, madje disa prej tyre kanë arritur të hyjnë dhe në tregjet e Bashkimit Evropian.

Në këtë pikë shton ai, Shqipëria për ta mbajtur ritmin duhet patjetër të rrisë standardin e cilësisë së produkteve.

“Eksportet po njohin rritje vitet e fundit. Trendi i rritjes së eksporteve do vijojë. Eksportet janë dhe drejt vendeve të Bashkimit Evropian.”, tha ai.



kombëtare të investimeve janë dorëzuar 400 aplikime. Kreu i Këshillit të Agrobiznesit, Agim Rrapaj, i ftuar në “Money Report” u shpreh se sektori i bujqësisë është i nënfinancuar, duke

“Ne kemi përshtypjen, kemi arritur në konkluzionin se bujqësia është e nënfinancuar duke e krahasuar me minimumet e veta. Në një analizë që kemi bërë, dhe disa sondazhe,

Lehtësohen procedurat për programet e punësimit - Mundësi të reja për trajnim e integrim të të rinjve

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive u bën thirrje punëdhënësve të kontribuojnë për përfshirjen në tregun e punës të të rinjve të moshës 15-29 vjeç, duke ofruar trajnime e punësim. Sipas AKPA janë 5254 oferta punësimi.

Punëdhënësit që kërkojnë të regjistrohen në programet e nxitjes së punësimit mund të aplikojnë online tek e-albania për “programin e të nxënit në vendin e punës”. Nga 4 dokumente të kërkuara, duhet të ngarkojnë vetëm një dhe përgjigja për aplikim mbërrin elektronikisht brenda 7 ditëve pune.

Por cilat janë kriteret që duhet të plotësojnë punëdhënësit?

Sipas Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive mund të aplikojnë vetëm punëdhënësit

që janë të regjistruar të paktën prej 6 muaj në QKB si biznes; nuk janë në proces falimenti; janë regjistruar si punëdhënës pranë AKPA-s; nuk kanë shkelje apo detyrime tatimore dhe plotësojnë të gjitha kushtet infrastrukturore dhe në burime njerëzore për t’u përfshirë në program.

Programi do të zbatohet fillimisht vetëm në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë.

Sipas të dhënave të INSTAT, në tremujorin e katërt të vitit

2023, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 66.7%, ose 0.2 pikë përqindje më e lartë krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, dhe është ulur me 1 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Ndërkohë, sipas shifrave, shkalla zyrtare e papunësisë për grupmoshën 15-29 vjeç është 22%, duke shënuar një rritje me 0.6 pikë përqindje, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë.



PROGRAMI GLOBAL PËR CILËSINË DHE STANDARDET, ZBATUAR NGA UNIDO DHE FINANCUAR NGA SECO

GJURMUESHMËRIA DHE BUJQËSIA ORGANIKE, TRAJNIMET QË FUQIZOJNË FERMERËT, NVM-TË, QTTB-TË DHE AREB-TË NË SHKODËR DHE KORÇË

UNIDO organizoi trajnime gjithëpërfshirëse tre-ditore në Shkodër dhe Korçë për të adresuar sfidat kryesore në sektorin bujqësor shqiptar me fokus bimët aromatike dhe medicinale. Fokusi kryesor ishte pajisja e pjesëmarrësve me njohuri dhe aftësi mbi gjurmueshmërinë dhe certifikimin organik, duke ndihmuar ata të përmbushin standardet ndërkombëtare dhe të përshtaten me ndryshimet e fundit ligjore dhe rregullatore

Në kuadër të Programit Global për Cilësinë dhe Standardet (GQSP) të Shqipërisë, të zbatuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO) dhe financuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), u organizuan trajnime gjithëpërfshirëse treditore në Shkodër dhe Korçë për të adresuar sfidat kryesore në sektorin bujqësor shqiptar me fokus bimët aromatike dhe medicinale. Këto trajnime synonin fuqizimin e fermerëve, përfaqësuesve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), si dhe specialistëve të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) dhe Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB). Fokusi kryesor ishte pajisja e pjesëmarrësve me njohuri dhe aftësi mbi gjurmueshmërinë dhe certifikimin organik, duke ndihmuar ata të përmbushin standardet ndërkombëtare dhe të përshtaten me ndryshimet e fundit ligjore dhe rregullatore. Një nga shtyllat kryesore të trajnimeve ishte përfshirja aktive e drejtorëve dhe specialistëve të Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB) të Shkodrës dhe Korçës, të cilët ofruan ekspertizën e tyre dhe ndanë përvoja nga terreni. Ata kontribuan me njohuritë e tyre praktike për nevojat dhe sfidat e fermerëve në këto rajone, duke e bërë trajnimin më të përshtatur dhe efektiv për realitetin shqiptar.

Trajnimet u ndërtuan për të përmbushur disa qëllime strategjike që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe përgatitjen e fermerëve për të përballuar sfidat e tregjeve globale:

- Certifikimi Organik:** Prezantimi i kërkesave kryesore për certifikimin organik, duke përfshirë Rregulloren e BE-së 848/2018 dhe Programin Kombëtar Organik të US-DA-së (NOP). Pjesëmarrësit mësuuan rëndësinë e këtyre standardeve për rritjen e besimit të konsumatorëve dhe përmirësimin e qasjes në tregje ndërkombëtare.
- Gjurmueshmëria:** Theksimi i rëndësisë së transparencës në zinxhirin e furnizimit, duke u fokusuar në dokumentimin dhe ndjekjen e produkteve nga ferma deri te konsumatori.
- Përfshirja e BAM-ve:** Trajnime të nënvizuan rolin e bimëve mjekësore dhe aromatike (BAM) në zhvillimin ekonomik lokal dhe potencialin e tyre për eksport.
- Rritja e Vlerës së Produkteve Lokale:** Promovimi i produkteve tradicionale dhe atyre me tregues gjeografik (GI) për të forcuar lidhjen midis agroturizmit dhe trashëgimisë kulturore.
- Forcimi i Bashkëpunimit:** Nxjitja e partneriteteve mes fermerëve, institucioneve lokale, AREB-ve dhe ekspertëve ndërkombëtarë për të zhvilluar praktika të qëndrueshme dhe të standardizuara.

Trajnimet në Shkodër: Roli i rajonit në ekonominë e BAM-ve

Shkodra, një nga rajonet më të rëndësishme në Shqipëri për kultivimin dhe përpunimin e bimëve mjekësore dhe aromatike (BAM), u shqua për rolin e saj aktiv në këtë iniciativë trajnimi. Tradita e pasur e rajonit në mbledhjen dhe përpunimin e këtyre bimëve, e kombinuar me potencialin për eksport, e bëri Shkodrën një nga pikat

kyçe për zhvillimin e kësaj nisme.

Trajnimet mbledhën fermerë, përpunues dhe përfaqësues të institucioneve vendore si AREB Shkodër dhe QTTB Shkodër. Përmes këtyre trajnimeve, pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe të ndajnë përvoja me ekspertët lokalë dhe ndërkombëtarë. Drejtori dhe specialistët e AREB Shkodër ndanë përvoja praktike mbi mbështetjen teknike të fermerëve dhe përpunuesve në rajon. Puna e tyre në fushën e certifikimit dhe përpunimit të BAM-ve ishte thelbësore për diskutimet mbi sfidat dhe mundësitë për zhvillimin e këtij sektori.

Një nga temat kryesore të trajtimeve ishte gjurmueshmëria dhe mënyrat sesi ajo mund të aplikohet në sektorin e BAM-ve. Përmes sesioneve interaktive, pjesëmarrësit mësuuan për:

- Implementimin e standardeve ndërkombëtare:** Trajnime prezantuan raste konkrete nga kompani lokale që përdorin standardet ISO 22005 për të ndjekur dhe dokumentuar origjinën dhe cilësinë e produkteve.
 - Rritjen e besimit të konsumatorëve:** Pjesëmarrësit mësuuan sesi gjurmueshmëria është një element kyç për të ndërtuar besimin e konsumatorëve dhe për të siguruar akses të qëndrueshëm në tregjet ndërkombëtare.
 - Optimizimin e proceseve të përpunimit:** U prezantuan mënyrat sesi teknologjitë e reja mund të përmirësojnë efikasitetin dhe cilësinë në përpunimin e BAM-ve, duke reduktuar humbjet dhe duke ruajtur vetitë natyrore të produkteve.
- Këto sesione ishin një mundësi për pjesëmarrësit që të zhvillojnë një kuptim më të thellë të rëndësisë së gjurmueshmërisë dhe mënyrave sesi ajo mund të zbatohet në praktikën e tyre të përditshme.

BAM-të dhe eksporti

Eksporti i BAM-ve ishte një tjetër temë thelbësore në trajnimet në Shkodër. Pjesëmarrësit u përfshinë në diskutime të detajuara mbi:

- Përputhshmërinë me kërkesat ndërkombëtare:** Pjesëmarrësit shqyrtuan rregulloret e BE-së dhe tregjeve të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë kërkesat për certifikim organik, paketim të sigurt dhe gjurmueshmëri.
- Rritjen e vlerës së produkteve për eksport:** Specialistët demonstuan sesi përpunimi dhe paketimi i duhur mund të rrisin ndjeshëm vlerën e BAM-ve në tregjet ndërkombëtare. Pjesëmarrësit u njohën me shembuj të suksesshëm nga kompani vendase që eksportojnë BAM-të në BE dhe SHBA.
- Zhvillimin e partneriteteve ndërkombëtare:** Pjesëmarrësit diskutuan mënyrat sesi bashkëpunimi me tregtarët dhe distributorët ndërkombëtarë mund të ndihmojë në zgjerimin e tregjeve dhe në krijimin e rrjeteve të qëndrueshme tregtare.

Ky komponent i trajnimit i dha pjesëmarrësve njohuri praktike dhe strategji për të fuqizuar kapacitetet e tyre për eksport dhe për të siguruar që produktet e Shkodrës të jenë konkurruese në tregjet globale.

Trajnimet në Shkodër jo vetëm që ndihmuan fermerët dhe përpunuesit të zhvillojnë aftësi të reja, por gjithashtu forcuan rolin e këtij rajoni si një qendër e rëndësishme për

prodhimin dhe përpunimin e BAM-ve në Shqipëri. Përmes kombinimit të traditës lokale dhe njohurive bashkëkohore, Shkodra ka potencialin për të shndërruar BAM-të e saj në një burim të fuqishëm të ardhurash për komunitetet lokale dhe për ekonominë kombëtare. Kjo qasje gjithëpërfshirëse vendos një bazë të fortë për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të BAM-ve, duke siguruar që Shkodra të jetë një shembull suksesi për rajonet e tjera të Shqipërisë.

Korça si një rajon kyç për bujqësinë dhe trajnimet mbi cilësinë dhe gjurmueshmërinë

Korça, e njohur për traditat e saj të pasura bujqësore dhe për tokat e saj pjellore, u shndërrua në një qendër kryesore për trajnimin mbi certifikimin organik dhe gjurmueshmërinë. Si një nga rajonet më të rëndësishme bujqësore në Shqipëri, Korça ofron potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e produkteve bujqësore cilësore dhe për integrimin e tyre në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Aktivitetet e trajnimit përfshinë një gamë të gjerë pjesëmarrësish, duke përfshirë fermerë, përpunues, përfaqësues të NVM, si dhe ekspertë nga AREB dhe QTTB. Një nga faktorët kryesorë për suksesin e trajnimit ishte përfshirja e Drejtorit dhe specialistëve të AREB Korçë, të cilët ndanë njohuritë e tyre praktike nga puna në terren. Specialistët ofruan shembuj të gjallë për sfidat që fermerët dhe përpunuesit hasin në rajon, duke përfshirë:

- Problemet me cilësinë e tokës dhe produktivitetin:** Specialistët ndanë teknika të ndryshme për përmirësimin e shëndetit të tokës dhe përdorimin më efikas të plehrave organike.
 - Mbështetjen për gjurmueshmërinë:** Ekspertët ofruan udhëzime të detajuara mbi rëndësinë e dokumentimit të ciklit të prodhimit dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare për gjurmueshmëri.
 - Certifikimi organik:** Specialistët ndanë përvoja mbi mbështetjen që ata ofrojnë për fermerët dhe përpunuesit që aplikojnë për certifikim organik, duke ndihmuar në navigimin e procesit burokratik dhe teknik.
- Puna e tyre ishte thelbësore për të përshtatur përmbajtjen e trajnimeve me nevojat specifike të fermerëve dhe përpunuesve të Korçës, duke e bërë trajnimet sa më praktike dhe me ndikim të menjëhershëm.

Certifikimi Organik dhe Gjurmueshmëria

Një nga shtyllat kryesore të trajnimit ishte njohja e pjesëmarrësve me proceset dhe standardet e certifikimit organik. Pjesëmarrësit mësuuan:

- Etiketimi organik:** Rëndësia e përputhjes me rregullat ndërkombëtare për etiketimin e produkteve organike dhe mënyrat për të fituar besimin e konsumatorëve.
- Standardi ISO 22005:** Njohuri të hollësishme mbi këtë standard ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për një sistem të qartë dhe të besueshëm të gjurmueshmërisë përgjatë zinxhirit të furnizimit.
- Përmirësimi i zinxhirit të furnizimit:** Strategji për të rritur transparencën dhe efikasitetin e zinxhirit të furnizimit, duke siguruar që produktet bujqësore të arrijnë tregjet me

Denaj prezanton p.buxhetin 2025 në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin: 15 miliardë lekë për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Anila Denaj prezantoi në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin projekt-buxhetin 2025 për bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

“Në 10 vitet e fundit mbështetja e qeverisë dedikuar sektorit bujqësor ka bërë të mundur, tëprekshëm dhe real zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit si dhe ruajtjen e dinamikës pozitive progresive të tij”, tha ministrja Denaj duke theksuar se sektori bujqësor është padiskutim një prioritet i qeverisë, investimi në të cilin e ka kthyer një prioritet dhe oportunitet për fermerët dhe bujqit në mbarë vendin.

Gjatë prezantimit të buxhetit ministrja Denaj theksoi se këtë vit janë fokusuar e do vijnë të fokusohemi në bashkimin e fermerëve, duke synuar nxitjen e investimeve në ekonomi shkallë, ulur kostot dhe rritur produktivitetin.

“Nevoja për mbështetjen e sektorit gjatë vitit të ardhshëm e në vijim është e domodoshme dhe investimet janë të fokusuara në produkte investimesh që ndihmojnë përmirësim të sigurisë ushqimore, si edhe në sisteme dhe infrastrukturë që kontribuon në terma më afatgjatë edhe për objektivat dhe vizionin tonë “Bujqësia 2030”.

Buxheti i pritshëm 2024, përfshirë Aktin Normativë fundvitit me shtesat në skemat e fermerëve, parashikohet 12% më i lartë krahasuar me buxhetin faktik 2023. Investimet e brendshme në objekte në 2024 janë rritur me mbi 10%.

“Me Aktin Normativ të fund vitit, buxheti Bujqësisë për skemat e mbështetjes pritet të jetë 52 milion euro dhe në 2025 projekttohet minimalisht 55 milion euro” theksoi ministrja Denaj.

Përsa i përket buxhetit të propozuar për vitin 2025, Denaj nënvizoi se buxheti i propozuar arrin në 15 miliardë lekë, një rritje prej afro 4% në krahasim me buxhetin e vitit 2024. Me anë të këtij buxheti do të mundësohet financimi i politikave si Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë, Siguria Ushqimore, Zhvillimi i qëndrueshëm i peshkimit dhe ekonomisë blu dhe Zhvillimi i kapaciteteve administrative dhe institucionale, bashkëpunimi i aktorëve, inovacioni dhe digjitalizimi.

“4.4 miliardë lekë nga buxheti do të shkojnë për mbështetje direkte për fermerët” u shpreh ministrja Denaj teksa theksoi se bashkimi i operatorëve do të jetë sërish në fokus të skemës për vitin 2025.

Në fokus të buxhetit për vitin 2025 do të jenë edhe siguria ushqimore me 2.6 miliardë lekë, si dhe infrastruktura ujëje-kullim dhe mbrojtje nga përmbytjet me një fond prej 2.9 miliardë lekësh.

Në 10 vitet e fundit mbështetja e qeverisë dedikuar sektorit bujqësor ka bërë të mundur, të prekshëm dhe real zhvillimin e

qëndrueshëm të sektorit si dhe ruajtjen e dinamikës pozitive progresive të tij.

Sektori bujqësor është padiskutim një prioritet i qeverisë, investimi në të cilin e ka kthyer një prioritet dhe oportunitet për fermerët dhe bujqit në mbarë vendin duke garantuar punësim,



ekonomi shkallë, mirëqënie sociale dhe zgjerim të aktivitetit bujqësor.

Këtë vit u fokusua e do vijojmë të fokusohemi në bashkimin e fermerëve, duke synuar nxitjen e investimeve në ekonomi shkallë, ulur kostot dhe rritur produktivitetin.

Nevoja për mbështetjen e sektorit gjatë vitit të ardhshëm e në vijim është e domodoshme dhe investimet janë të fokusuara në produkte investimesh që ndihmojnë përmirësim të sigurisë ushqimore, si edhe në sisteme dhe infrastrukturë që kontribuon në terma më afatgjatë edhe për objektivat dhe vizionin tonë “Bujqësia 2030”.

Buxheti i pritshëm 2024 (përfshirë AN e fundvitit me shtesat në skemat e fermerëve) parashikohet 12% më i lartë krahasuar me buxhetin faktik 2023. Investimet e brendshme në objekte në 2024 janë rritur me mbi 10%.

Me AN të fund vitit, buxheti Bujqësisë për skemat e mbështetjes pritet të jetë 52 milion euro dhe në 2025 projekttohet minimalisht 55 milion euro.

Projekt buxheti i vitit 2025 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është planifikuar në total 15 miliardë lekë ose afro 4% më i lartë se viti 2024,

Nëpërmjet këtij buxheti do të mundësojmë financimin e politikave si:

- Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë
- Siguria Ushqimore
- Zhvillimi i qëndrueshëm i peshkimit dhe ekonomisë blu
- Zhvillimi i kapaciteteve administrative dhe institucionale, bashkëpunimi i aktorëve, inovacioni dhe digjitalizimi

Këto politika do të realizohen sipas 7 programeve buxhetor, si vijon:

1. Me mbështetjen në bujqësi me 7.3 miliardë të buxhetit fill-estar 2025, në dispozicion vetëm për financimin e Zhvillimit Rural, ndër të cilat 4.4 miliardë përbëjnë mbështetje të drejtpërdrejtë për fermerët.

Edhe gjatë vitit 2025, fokusi do të jetë bashkimi i operatorëve

nëpërmjet incentivimit të grupeve të prodhuesve dhe “Contract farming” përgjatë zinxhirit të vlerës.

2. Në Programin Siguria Ushqimore në vitin 2025 do të kemi një mbështetje 2.6 miliardë lekë për Garantimin e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjen e Konsumatorit.

3. Në programin Menaxhimin e Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, nëpërmjet një mbështetje me buxhet prej 2.9 miliardë lekë, ose 13% më shumë se ky vit

4. Në programin Mbështetje për Peshkimin kemi në fokus zhvillimin e qëndrueshëm të peshkimit dhe akuakulturës dhe shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve peshkore. Do të financojmë kështu politikat e sektorit me një buxhet prej 527 milionë lekë, ose 11.5% më shumë se në vitin 2024. Investimet në programin e peshkimit synojnë rritjen e prodhimit të produkteve peshkore me 10-20% dhe eksportet në masën 60-70%.

5. Në programin Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor me një buxhet prej 757 milion lekë, ose 7% më shumë se buxheti fill-estar 2024

6. Në programin Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore, do të realizohen objektivat si më poshtë:

- Krijimi i informacionit për tokën
- Dixhitalizimi i Regjistrimit të Tokës Bujqësore
- Integrimi në aplikacionin e EEB-GIS të 10 bashkive (100 njësi administrative)
- Programi Planifikim Menaxhim Administrimi ofron: Mbështetje administrative, me produkt kryesor përafrimin e politikave shqiptare me “aquis communautaire” të Bashkimit European.

Gripi i shpendëve, MBZHR ndalon importet nga 17 shtete evropiane

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përmes urdhrave të posaçëm ka marrë masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Kroacisë, Danimarkës, Italisë, Bullgarisë, Hungarisë, Gjermanisë, Polonisë, Francës, Çekisë, Sllovakisë, Rumanisë, Moldavisë, Spanjë, Portugalisë, Francës, Norvegjisë, Austrisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Masat përfshijnë ndalimin e importit, e tranzit-

imit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të: shpendëve të gjallë shtëpiakë; zogjve 24-orësh; shpendëve dekorativë; materialit biologjik të shpendëve; vezëve të shpendëve; mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht; nën-produkteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Sipas të dhënave nga IN-STAT, në vitin 2023 numri i pulave në Shqipëri regjistrohet në 4.8 milionë krerë dhe numri i vezëve në 894 milionë kokrra.

Po ashtu, njëkohësisht Ministria e Bujqësisë ka marrë masa

për tu mbrojtur nga sëmundja e lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në Greqi, Turqi, Bullgari. Dhe në këtë rast masat përfshijnë ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik dhe nën-produkteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta.

Masat nënjëta janë marrë edhe për mbrojtjen ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në Suedi, Danimarkë, Portugali, Austri, Holandë dhe Spanjë.

Gonxhja: Përmirësim i aksesit në financë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Ministri i Ekonomisë, Mikro, të Vogla dhe të Mesme Kulturës dhe Inovacionit, (NMVM) dhe Rekomandime



Blendi Gonxhja mori pjesë në Këshillin e Investimeve për prezantimin mbi “Aksesin në Financë për Ndërmarrjet

për Përmirësimin e Instrumenteve të Financimit”, ku u diskutuan sfidat kryesore me të cilat përballen këto ndërmarrje në

Shqipëri.

Sipas ministrit seanca u përqendrua tek rëndësia e aksesit në financë për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e sipërmarrjes.

Nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, ministri Gonxhja nënvizon se gjatë diskutimeve u theksuan nisja për zhvillimin e kuadrit rregullator për krijimin e Byrove Private të Kredive.

Po ashtu, bën me dije ministri Gonxhja, u diskutua edhe për vështirësitë në sigurimin e financimeve për NMVM-të, përfshirë kriteret e larta dhe procedurat burokratike.

Një tjetër pikë që është theksuar gjatë diskutimeve, sipas ministrit ishte nevoja për përmirësimin e njohurive financiare në sektorin privat si dhe potenciali i digjitalizimit dhe për të përshpejtuar proceset bankare dhe vlerësimin e kredive.

“U ndanë gjithashtu rekomandime për përmirësimin e skemave të garantimit të kredive dhe mbështetjen për bizneset e drejtuara nga gratë, duke nxitur një klimë më të barabartë dhe të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik”, përfundoi Gonxhja.

Projekt pilot - Ndryshojnë njësitë e tregtimit të fruta-perimeve/ Agjencia hap tenderin për tezgat e reja në tregjet e Tiranës

Agjencia e Administrimit të Tregjeve në Tiranë po eksperimenton një lloj të ri tezgje për njësitë e tregtimit të fruta-perimeve. Agjencia ka shpallur tenderin me vlerë 3.6 milionë lekë për realizimin e projektit pilot.

Projekti i tezgave të reja synon përmirësimin e cilësisë së kushteve të tregtimit, me qëllim që ato të jenë sa më funksionale për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të fruta-perimeve.

Njësitë e reja të tregtimit janë projektuar të jenë metalike, me ekspozitor dhe me mbulesë kundër shiut. Projekti pilot parashikon prodhimin e 20 tezgave të para, që nëse



do të rezultojnë efikase, mund të shtrihet më tej në tregje të tjera.

Agjencia e Administrimit të Tregjeve është institucion në varësi të Bashkisë Tiranë,

i krijuar në vitin 2017. Kjo agjenci administron 10 tregje të rëndësishme të Tiranës, mes të cilëve atë të Pazarit të Ri, 1 maji, Petro Nini etj.

Si po transformohet industria e bimëve mjekësore? - Mungesa e fuqisë punëtore / Nga “gjurmimi” në male tek kultivimi total

Zhvillimi i Teknologjisë dhe Transferimi i Njohurive në Sektorin e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike në Shqipëri (BMA)

Në mungesë të fuqisë punëtore dhe sigurimit të bimëve të egra mjekësore, industria po mbështetet për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe gjurmueshmërinë, duke mundësuar kalimin nga mbledhja në natyrë drejt kultivimit të qëndrueshëm si dhe duke ulur kostot me qëllim rritjen e eksporteve.

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka bërë bashkë aktorë të sektorit privat, akademinë, ekspertë ndërkombëtarë dhe donatorë në një forum i cili kishte në thelb zhvillimin e teknologjisë dhe transferimin e njohurive në sektorin e bimëve aromatiko-mjekësore në Shqipëri.

Për herë të parë sektori privat ka nënshkruar një marrëveshje partneriteti me Universitetin Bujqësor të Tiranës për të drejtuar zhvillimin e ardhshëm të sektorit.


Kjo ndërhyrje është mbështetur nga RisiAlbania, një projekt i financuar nga

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Aktualisht 90 % e bimëve mjekësore që tregtohen jashtë janë të kultivuara.

Nga kjo industri përfitojnë të ardhura mbi 4 mijë familje.

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT), në bashkëpunim me aktorët e sektorit privat, shoqatat e sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA), dhe me mbështetjen e RisiAlbania, një projekt i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe i zbatuar nga Helvetas dhe Partnerët Shqipëri, organizuan konferencën kombëtare të fokusuar në transformimin e sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike në Shqipëri.

Konferenca, e titulluar “Zhvillimi i Teknologjisë dhe Transferimi i Njohurive në Sektorin e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike në Shqipëri,” u mbajt në UBT. Konferenca



synon të mbledhë së bashku aktorët kryesorë të industrisë, duke përfshirë politikbërjen, akademinë, ekspertë ndërkombëtarë, biznese, donatorë dhe blerës ndërkombëtarë, për të diskutuar dhe avancuar sektorin e BMAve në Shqipëri.

Për herë të parë, UBT dhe sektori privat, i përfaqësuar nga dy shoqata kryesore të BMAve, kanë nënshkruar një marrëveshje partneriteti për të drejtuar zhvillimin e ardhshëm të sektorit. Ky bash-

këpunim shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të industrisë së BMAve në Shqipëri. Kompendiumi Kombëtar i Bimëve Mjekësore dhe Aromatike, i zhvilluar përmes një partneriteti midis UBT, Qendrës Zvicerane të Ekselencës në Bujqësi (Agroscope), dhe sektorit privat, me mbështetjen e RisiAlbania, ofron njohuri të rëndësishme mbi kultivimin e BMAve, menaxhimin e cilësisë dhe strategjitë e tregut. Dokumenti synon të ndihmojë

aktorët e sektorit në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe gjurmueshmërisë, duke mundësuar kalimin nga mbledhja në natyrë, drejt kultivimit të qëndrueshëm.

Konferenca u përshëndet nga figura të rëndësishme. Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, Rectori i UBT, qe foli mbi rolin e akademisë në avancimin e inovacionit bujqësor, Arjan Jaupllari, Zëvendës Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i cili diskutoi mbi vizionin strategjik të Ministrisë për sektorin e BMAve. Stephan Joss, Koordinator Kombëtar i Helvetas, theksoi kontributet e projektit në sektorin e BMAve dhe objektivat e tij më të gjera të zhvillimit.

Agjenda përfshin prezantimin e Kompendiumit të BMAve nga Prof. Dr. Ilir Kristo, Prof. Dr. Endrit Kullaj, dhe Prof. Dr. Alban Ibrahliu, të cilët diskutuan se si kompendiumi mbështet sektorin në standardet e cilësisë, mekan-

izimin dhe konkurrencën në eksport. Gjithashtu, Prof. Dr. Bernhard Streit nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Bernës prezantoi potencialin e Shqipërisë për bujqësi rigjeneruese.

Panelet thelluan rolin e shoqatave të BMAve në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe nevojën për një platformë kombëtare për të koordinuar përpjekjet e sektorit. Diskutimet do të mbulojnë gjithashtu tendencat e tregut ndërkombëtar dhe kërkesat specifike të blerësve me vlerë të lartë, me kontribute nga përfaqësues të sektorit privat dhe blerës ndërkombëtarë.

Pjesëmarrësit paten mundësi të angazhohen konkretisht në diskutime gjatë sesioneve të rrjetëzimit të konferencës. Kjo platformë inkurajon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive, duke lehtësuar rrugën e sektorit drejt rritjes së konkurrueshmërisë, qëndrueshmërisë dhe arritjes në treg.



SI PO TRANSFORMOHET INDUSTRIA E BIMËVE MJEKËSORE? MUNGESA E FUQISË PUNËTORE/ NGA “GJURMIMI” NË MALE TEK KULTIVIMI TOTAL



SI PO TRANSFORMOHET INDUSTRIA E BIMËVE MJEKËSORE? MUNGESA E FUQISË PUNËTORE/ NGA “GJURMIMI” NË MALE TEK KULTIVIMI TOTAL

FSHZH, “megaprojekt” për rigjenerimin e fshatrave të Shqipërisë - Rikualifikim urban dhe sistemim rrugësh për 4 rajonet e vendit

Fondi Shqiptar i Zhvillimit po bëhet gati që të nisë një projekt kombëtar investimi për rigjenerimin urban në 4 rajonet e vendit. Fokusi i ndërhyrjeve do të jenë fshatrat me popullsi të dendur si dhe zonat periferike dhe informale.

Për këtë qëllim janë shpallur dy tenderë, ku ajo për rajonet 1 dhe 2 të vendit ka si fond limit 439 milionë lekë ndërsa ai për rajonet 3 dhe 4 ka si fond limit 416 milionë lekë.

Referuar dokumenteve të tenderëve, qëllimi kryesor i projektit është rritja e cilësisë së jetës së komuniteteve që popullojnë në zonat urbane dhe lidhja e zonave turistike që kanë potencial për zhvillimin ekonomik dhe social. Ndërhyrjet do të përmirë-

sojnë qarkullimin e automjeteve, njerëzve dhe do të rrisë

it, hapësirat rekreative etj. Projekti “Rigjenerimi urban



sigurinë e lëvizjes.

Projekti parashikon rikualifikimin e blloqeve urbane duke sistemuar rrugët, trotualet, lulishtet, fasadat e pallateve apo godinave, ambientet e pushim-

në zonat periferike, informale dhe në fshatra me popullsi të dendur është parashikuar të financohet në kuadër të Programit Operacional 2022-2024 të FSHZH-së.

Denaj ndan historinë e fermerit në Tropojë, eksporton 50 ton gështenja

Valter Milushi në Tropojë, në një sipërfaqe prej 6 hektarësh, kultivon gështenja dhe ka një stabiliment me parametrat e kohës e me kushte frigoriferike për grumbullimin, përpunimin dhe ambalazhimin e gështenjës, me destinacion eksportin e tyre në vendet e BE-së.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj ndau në rrjete sociale historinë e tij, si një ndër shembujt e fermerëve që me përkushtim dhe kujdes, punojnë tokën e tyre dhe zhvillojnë biznesin bujqësor, duke prodhuar jo vetëm për tregun vendas por edhe për eksport.

Denaj tha se, këtë vit, Valteri ka grumbulluar rreth 50 ton prodhim nga fermerët e kësaj zone, që shkon për eksport, duke çuar produktet “Made in Albania” në tregjet ndërkombëtare.

“Lufta biologjike që po aplikohet kundër dëmtuesit të gështenjës në këtë zonë pritet të rrisë sasinë dhe cilësinë e prodhimit të kësaj kulture në vijim, nën monitorimin e vazhdueshëm nga specialistët e

ekstensionit të kësaj zone”, u shpreh Denja.

Tropoja ka 2700 ha sipërfaqe me gështenja. Kjo zonë është pasuri kombëtare dhe përbën një hapësirë të rëndësishme ekonomike.



AKTUALITET

Agroturizmet në Krujë, Denaj: Destinacione të shijes autentike shqiptare

Kruja, përtej asaj që është kthyer sot në një destinacion të turizmit historiko-kulturor,

dhe të tashmes përmes shijes autentike shqiptare”, shkroi Denaj.



po njeh fluks në rritje të turistëve vendas dhe të huaj që po nxitet edhe nga investimet në sektorin e agroturizmit.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj ndau në rrjetet sociale historinë e investimit të familjes Bardhi.

“Ky agroturizëm i ngritur mes madhështisë së Kalasë së Krujës, është destinacioni që lidh përvojën e së kaluarës

Ministria tha se, me një mikpritje të ngrohtë dhe përkushtim të veçantë deri në detaje, ky agroturizëm ofron për vizitorët vendas e të huaj produkte cilësore “Made in Albania”, nga ferma në tavolinë, duke nxitur rritjen e ekonomisë lokale dhe punësimin në zonë.

Djali i familjes Bardhi tregoi se si nisi ky investim, fillimisht për ngritjen e

fermës blegtorale, me pas me ndërtimin e serrave, ku prodhohen të gjitha llojet e perimeve, ngritjen e vreshtave dhe ndërtimin e kantinës së verës dhe deri në investimin për ngritjen e njëjësive akomoduese, që e kanë kthyer këtë investim në një sipërmarrje agroturistike me të gjithë elementët përkatës.

Ai tregon se vizitorët e shumë kanë interes të njohin zonën, por edhe të shijojnë kulinarinë, që ofron ushqime dhe gatime cilësore me produkte të fermës familjare.

“Turistët pothuajse vijnë nga e gjithë bota. Puna sa vjen e shtohet. Kjo punë do pasion brenda, për ta realizuar siç duhet. Këtu produktet janë 100% bio.”

“Për shkak të fluksit të lartë të turistëve, ne po bashkëpunojmë edhe me fermerë të zonës për furnizimin me prodhime bujqësore, që janë 100% të zonës së Krujës dhe janë shumë cilësore e organike”, tha ai.

Gripi i shpendëve, MZHBR: Nuk ka dyshime për raste të reja



Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural informoi se nuk ka dyshime dhe rikonfirmime të rasteve të reja për influencën aviare në Shqipëri.

“Në harkun javor 30 tetor – 7 nëntor 2024, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka vijuar monitorimin në fshatrat e zonës së mbikëqyrjes 3 km dhe atë të zonës së mbrojtjes 10 km, për të kontrolluar dhe inventarizuar 3935 ferma shpendësh të madhësive të ndryshme. Nga kontrolli fizik i shpendëve në këto ferma, gjendja shëndetësore është paraqitur pa shqetësime lidhur me kuadrin klinik të influencës aviare”, theksoi MBZHR në një njoftim për medie.

Sipas ministrisë, Qendrat Kombëtare dhe Rajonale të Krizës kanë vazhduar raportimin dhe koordinimin

ditor deri në mbylljen e rastit dhe daljen nga karantina të vatrës pozitive.

“Për gjurmim të hershëm dhe kufizim të përhapjes së sëmundjes, shërbimi veterinar i AKVMB ka marrë dhe dërguar në ISUV 209 mostra për analizim rreth rrezes 3 km dhe 10 km. Në zbatim të Programit të Survejancës aktive për fazën e tretë që ka filluar në tetor për Sëmundjen e Influencës Aviare kanë mbërritur në Laboratorin e Referencës – ISUV 140 kampione nga rajone të tjera, përkatësisht qarku Elbasan, Korçë, Shkodër, Lezhë, Dibër, Fier. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë informon se rezultatet e analizave deri në datën 6.11.2024, kanë rezultuar negative për influencë aviare me metodën konfirmatore RT-PCR”, theksohet në njoftim.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon se ka vijuar monitorimet për të gjithë qarkun Tiranë, ku nuk janë konstatuar probleme me tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe specifikisht nga shpendët. Kontrolli është ushtruar në 22 subjekte tregtare të vezëve, mishit të pulës dhe restorante.

Instituti i Shëndetit Publik informon se është në monitorim të vazhdueshëm të situatës shëndetësore në njerëz, ku deri më sot nuk ka njoftime apo raste të dyshuara për simptoma të ngjashme respiratore. Gjithashtu, ISHP është në kontakt të vazhdueshëm me mjekët e familjes.

MBZHR njofton konsumatorin të konsumojë produkte të certifikuara dhe kontrolluara nga autoritetet përkatëse, të ruajë kushtet higjienike, si dhe të sigurojë trajtimin termik në temperatura të larta gjatë konsumit të produkteve me origjinë shtazore.

Kërkohet ndërgjegjësim dhe bashkëpunim nga fermerët e shpendërritësit e të gjitha kategorive, të rrisin masat e biosigurisë, kufizojnë kontaktin e shpendëve të tyre me shpendët e egër për uljen e riskut të ekspozimit.

Shqipëria merr pjesë për herë të parë në Panairin e Ushqimit në SHBA organizuar nga AIDA

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) organizoi për herë të parë pjesëmarrjen me stendë në “Panairin e Përbërësve të Ushqimit” (Food Ingredients North America) të Amerikës së Veriut në datat 30-31 tetor 2024.

Ngjarja e kësaj viti në Las Vegas shënon një moment historik për agrobizneset shqiptare, pasi ato prezantojnë produktet e tyre para mbi

Shtetër Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO). Ky projekt synon të nxisë sfida e eksporteve dhe të nxisë specialist ekonomik rajonal. Mbështetja e SME-ve shqiptare në zgjerimin e shtrirjes së tyre shfaqet hap dyert për produkte të zhytura në vazhdim, por të veçanta për tregjet e sotme globale.

Panairi i Përbërësve të Ushqimit në Amerikën e Veriut nuk është thjesht një shfaqje

ofron akses në seminare dhe biseda financiare sektoriale mbi tema të tilla si qëndrueshmëri dhe transformim digjital, të cilat përputhen me qëllimet e strategjive të Pavijonit Shqiptar. Ky ndaj ekspozit ndaj tendencave moderne të industrisë do t’u ekspozojë një gjë të tillë që mund të aplikohet për të forcuar sektorin e agrobiznesit në Shqipëri.

Ndërsa Shqipëria vazhdon



18,500 më shumë se industrisë nga e gjithë bota.

Pavijoni i Shqipërisë në stendën 1231 ishte plot me vizitorë, teksa prodhuesit kryesorë shqiptarë të vajit të ullirit, bimëve mjekësore dhe bimëve aromatike shfaqen produktet e tyre në një nga skenat më prestigjioze në botë. Vizitorët mësuan më shumë mbi njerëzit e pasur të Shqipërisë dhe takimet me përfaqësuesit e kompanive që mishërojnë përkushtim ndaj studentëve, inovacionit dhe praktikave të tyre.

Thelbi i kësaj nisme është projekti “Promovimi i Tregtisë Lindore: Shtetet e Ballkanit dhe Azia Qendrore” i Qendrës Ndërkombëtare të Tregtisë (ITC), dhe nga Sekretariati

tregtare, është një qendër për inacionin, duke u siguruar që sektori i ushqimit të të gjithëve, pijeve dhe shëndetit. Me mbi 130 ekspozues, panairi u ofron kompanive shqiptare një mundësi për t’u lidhur me problemet kryesore, për të eksploruar teknologjitë e reja dhe për të tendencat që po japin formë industrisë. Përveç rrjetëzimit, këto kompani do t’i përshatën njohurive për gjërat më të fundit të Amerikës së Veriut, nga certifikatat e organikës deri tek rritja e interesit për produktet me bazë bimore.

Kompanitë shqiptare mund të bëjnë produktet e tyre dhe të zgjerojnë ofertat e tyre duke marrë pjesë në këtë ngjarje të menaxherëve nga ITC. Panairi

të jetë hapa përpara në bujqësi të ditës, panairi Amerikan e Veriut shërben si një historik për sektorin e saj të agrobiznesit. Kjo mundësi për të dalluar e Shqipërisë me një audiencë globale pasqyron misionin e ITC për të krijuar “ndikim tregtar të emocionuar që sjell produkte tona në Las Vegas, për të ndarë një pjesë të gjithë Shqipërisë dhe inovacionit të me botën”, thotë Gent. Beqiri, Menaxher i Projektit të ITC për këtë iniciativë.

Sipas tij, “kompanitë shqiptare të plotësojnë kërkesën për produktet me cilësi të lartë, natyrale dhe të tjera nuk besojmë se kjo sukses do të jetë një hap për të ardhmen në të ardhmen.”

Abuzimi me çmimet në tregun e grumbullimit të fruta-perimeve, Konkurrenca hetim në 5 qarqe

Autoriteti i Konkurrencës (AK) hapi procedurën e hetimit të thelluar në tregun e

Sipas njoftimit të AK-së, ky hetim do të përfshijë periudhën nga 1 janari 2023, deri më 30



grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarqet Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.

shtator të këtij viti.

AK njofton se, “pas analizimit të strukturës së tregut, integritimit vertikal, sjelljes së

ndërmarrjeve grumbulluese dhe diferencave të mëdha në zinxhirin e vlerës së produktit nga prodhuesit, grumbulluesit, shitësit me shumicë deri te konsumatori fundor, u vlerësua se ky treg mund të ketë sjellje antikonkurruese, si pasojë e marrëveshjeve dhe/ose praktikave të bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, në bazë të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.”

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 1114, datë 04.10.2024 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar për këto tregje.

Denaj: Platformë digjitale për të dhënat e tokës bujqësore

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj thotë se rëndësia e analizimit të cilësisë së tokës përmes teknologjisë së avancuar, çon në një menaxhim më të mirë dhe të qëndrueshëm të tokës bujqësore.

Në kuadër të programit “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore”, specialistët

aksesueshëm për çdo fermer kudo në Shqipëri.

Kjo platformë ofron: Përcaktimin e kulturës më të përshatshme për çdo zonë; Rritjen e efektivitetit të inputeve bujqësore, uljen e kostove dhe mbrojtjen e mjedisit; Zbatimin e teknologjive të avancuara për prodhim më të lartë dhe cilësi të qëndrueshme.



e QTTB Fushë-Krujë morën mostra të tokës në njësinë administrative Maqellarë, bashkia Dibër, për t'i analizuar në laboratorin e QTTB.

Pas analizimit, të dhënat e përpunuara përmes GIS dhe të ngarkuara në platformën Web-GIS bëjnë të mundur që informacioni për cilësinë dhe përdorimin e tokës të jetë i

“Ky sistem ndihmon fermerët të njohin më mirë tokën e tyre dhe të marrin vendime të informuara për mbjellje, plehërim, punim dhe mbrojtje, duke garantuar zhvillim të qëndrueshëm dhe fitim të lartë ekonomik”, u shpreh ministria Denaj në rrjetet sociale.

Regjistrat e tokës bujqësore në vend janë digjitalizuar në

masën 60%, sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. MBZHR bën të ditur se, paralelisht me regjistrimin është krijuar Sistemi i Informacionit për Tokën për të paktën 448 541 ha, ose 65.2% të totalit të tokës bujqësore në shkallë vendi. Programi “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës” ka si synim edhe digjitalizimin. Gjatë vitit 2023 janë digjitalizuar rreth 15 000 ha tokë bujqësore në njësitë administrative Qukës të qarkut Elbasan, Hekal të qarkut Fier, Fajzë të Qarkut të Kukësit, Helmës të Qarkut të Tiranës, Blinisht dhe Zejmen të Qarkut të Lezhës.

Sipas raportit të MBZHR-së, në përfundim të fazave të regjistrimit-digjitalizimit janë kryer: Inventarizimi dhe klasifikimi i tokave bujqësore sipas përshtatshmërisë së saj; Mbledhja e informacionit për përdorimin/mbulesë tokësore për vitin që është kryer regjistrimi fillestar dhe 2023 si dhe analizimi i dinamikës së ndryshimeve në përdorimin e tokës bazuar te parcela; Studimi agro-ekologjik i zonave në studim; Digjitalizimi i regjistrit të tokës bujqësore për 4 njësi administrative; Krijimi i programit WEB-GIS për të dhënat e tokës.

“Anti-përmbytja” llogaritet në 100 milionë dollarë në vit - Ku duhet investuar më shumë për të “shpëtuar” fermerët nga dëmet ekonomike?

Sa e përgatitur është Shqipëria për të përballuar rrezikun që vjen nga përmbytjet dhe ndryshimet klimatike, për shkak të investimeve të pamjaftueshme parandaluese në këtë drejtim?

Historiku i viteve të fundit ka treguar që intensiteti i shirave në periudhën vjeshtë-dimër ka sjellë përmbytje të vazhdueshme në zona të caktuara të vendit, me pasojë dëme të konsiderueshme për fermerët dhe agrobizneset.

Në vitin 2019, qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare të Ujitjes dhe Kullimit 2019– 2031 dhe planin e veprimit e cila kishte pikërisht në fokus marrjen e masave konkrete në këtë drejtim për të parandaluar përmbytjet, por mesa duket 5 vite pas, efektet kanë qenë minimale.

Por sa do të kushtonte e gjithë ndërhyra e nevojshme për shmangien e këtij fenomeni që sjellë dëme të pallogaritshme çdo vit për familjet shqiptare dhe sa e përballon buxheti i shtetit?

Sipas vlerësimit të bërë nga Ministria e Bujqësisë, për një periudhë 10-13 vjeçare, ku llogaritja është bërë që nga viti 2019, kostoja totale për rehabilitimin dhe modernizimin e infrastruk-

turës së ujitjes, infrastrukturës së kullimit, digave të rezervuarëve të ujitjes dhe objekteve të mbrojtjes nga përmbytja, është

së mbrojtjes nga përmbytja lumore dhe detare, nëpërmje rehabilitimit/ rikonstruksioni të argjinaturave ekzistuese dhe



rreth 717 milionë USD.

Nga ky total 253.6 milionë USD, vlerësohet rehabilitimi dhe modernizimi i infrastrukturës së ujitjes për të mundësuar ujitjen në sipërfaqen potencialisht të ujitshme prej 360 mijë ha; 56.5 milionë USD rikthimi i infrastrukturës së kullimit në parametra optimal në sipërfaqen potencialisht të kalueshme prej 280 mijë ha; 130.2 milionë USD rehabilitimi i 410 digave (ose rreth 65% e numrit të përgjithshëm) për rritjen e sigurisë së tyre dhe garantimin e burimeve ujore për skemat ekzistuese; 276.8 milionë USD rritje e sigurisë

ndërtimit të strukturave reja.

Ndërkohë që duke zbritur investimet që janë bërë deri në 2022, nga viti 2022-2031, llogaritet një nivel investimi rreth 700 milionë dollarë.

Ministria e Bujqësisë theksoi pak ditë më parë se kjo faturë është ende në të njëjtat nivele, çka do të thotë se nëse do të mbulohej nga buxheti i shtetit, do të duhej të vendoseshin në dispozicion mesatarisht afro 100 milionë dollarë në vit deri në 2031-shin me qëllim zgjidhjen e këtij problemi, ndërkohë që fondet vjetore të akorduara për këtë zë në buxhet mbulojnë vetëm 20 për qind e nevojës për tu investuar.

Gjurmueshmëria dhe Bujqësia Organike, trajnimet që fuqizojnë fermerët, NVM-të, QTTB-të dhe AREB-të në Shkodër dhe Korçë

(Vijon nga faja 3)

cilësi dhe integritet të plotë.

Diskutimet praktike dhe shembujt konkretë nga rajoni ndihmuan pjesëmarrësit të zhvillojnë një kuptim më të mirë të aplikimit të standardeve të gjurmueshmërisë në fermat dhe proceset e tyre të përpunimit.

BAM-të dhe Turizmi

Një komponent tjetër i rëndësishëm i trajnimit ishte lidhja mes bimëve mjekësore dhe aromatike dhe agroturizmit. Korça, me peizazhet e saj unike dhe trashëgiminë e saj kulturore, ka potencial të jashtëzakonshëm për të promovuar BAM-të si një atraksion për turistët dhe një burim i qëndrueshëm të ardhurash për komunitetet lokale.

Pjesëmarrësit shqyrtuan raste studimore, si rasti i Liqenit të Prespës, ku produktet tradicionale dhe BAM-të po përdoren për të zhvilluar agroturizmin. Përmes këtij segmenti, pjesëmarrësit mësuam:

- **Marketingu i produkteve tradicionale:** Si të përdoren historitë unike të produkteve dhe lidhjet e tyre me rajonin për të tërhequr turistë dhe konsumatorë ndërkombëtarë.

- **Potenciali ekonomik i BAM-ve:** Si mund të integrohen BAM-të në paketat turistike dhe të krijohen përvoja unike për vizitorët, duke përfshirë turne në ferma, aktivitete për mbledhjen e bimëve, dhe demonstrime për përpunimin e tyre.

- **Produkte me tregues gjeografik:** Rëndësia e certifikimit GI për të rritur vlerën e produkteve dhe për të krijuar një imazh unik dhe të mbrojtur për produktet e rajonit.

Potenciali i Korçës për zhvillimin e qendrueshëm

Trajnimet në Korçë nxorën në pah potencialin e jashtëzakonshëm të rajonit për të udhëhequr zhvillimin e bujqësisë organike dhe promovimin e BAM-ve në tregjet kombëtare

dhe ndërkombëtare. Duke kombinuar njohuritë tradicionale me praktikatat moderne dhe standardet ndërkombëtare, Korça mund të shndërrohet në një model për zhvillimin e qëndrueshëm rural në Shqipëri.

Këto trajnime ishin vetëm fillimi i një procesi transformimi për fermerët dhe përpunuesit e rajonit, duke u ofruar atyre njohuri, mjete dhe mbështetje për të përmirësuar cilësinë, rritur produktivitetin dhe zgjeruar tregjet e tyre. Përmes bashkëpunimit me AREB dhe QTTB, Korça ka mundësinë të udhëheqë një epokë të re të inovacionit dhe qëndrueshmërisë në bujqësinë shqiptare.

Trajnimet e zhvilluara në Korçë dhe Shkodër sollën një ndikim të madh për pjesëmarrësit dhe sektorin bujqësor në tërësi, duke prodhuar rezultate të matshme dhe konkrete:

Njohuri të avancuara

Pjesëmarrësit u pajisën me njohuri të thelluara mbi certifikimin organik dhe standardet e gjurmueshmërisë, që janë thelbësore për të përmbushur kërkesat e tregjeve globale. Këto njohuri praktikisht i ndihmuan ata të kuptojnë dhe zbatojnë kërkesat ligjore dhe rregulloret ndërkombëtare si Rregullorja e BE-së 848/2018 dhe standardet e USDA-së. Pjesëmarrësit mësuam sesi të përmirësojnë cilësinë e produkteve të tyre dhe të zbatojnë një zinxhir furnizimi të besueshëm e transparent, i cili është vendimtar për sigurinë ushqimore dhe për ndërtimin e besimit të konsumatorëve.

Forcimi i rrjeteve

Një nga rezultatet më të rëndësishme të trajnimeve ishte krijimi dhe forcimi i lidhjeve mes fermerëve, përpunuesve dhe institucioneve vendore si AREB-të dhe QTTB. Specialistët e AREB-ve të Shkodrës dhe Korçës luajtën një rol vendimtar në lehtësimin e këtij bashkëpunimi duke ndarë përvoja nga terreni dhe duke ofruar mbështetje teknike. Ky bashkëpunim rajonal u shqua si një shtysë për të nxitur zh-

villimin e praktikave të përbashkëta dhe për të rritur kapacitetet institucionale për mbështetje afatgjatë të fermerëve.

Rritja e qasjes në treg


Njohuritë mbi vlerësimin dhe promovimin e bimëve mjekësore dhe aromatike dhe produkteve tradicionale si pjesë e zinxhirit të vlerës ishin një tjetër rezultat kyç i trajnimeve. Pjesëmarrësit mësuam sesi të shtojnë vlerën e produkteve të tyre duke përmirësuar cilësinë dhe paketimin, duke plotësuar standardet për eksport dhe duke i promovuar ato si atraksione për turizmin. Këto aftësi krijojnë mundësi të reja për pjesëmarrësit që të rrisin të ardhurat dhe të fuqizojnë ekonomitë lokale.

Rruga përpara: Ngritja e një sektori të qëndrueshëm

Trajnimet në Korçë dhe Shkodër shënojnë një hap të rëndësishëm drejt transformimit të sektorit bujqësor në Shqipëri. Përfshirja e drejtorëve dhe specialistëve të AREB-ve siguroi që pjesëmarrësit të merrnin njohuri të përshtatura për nevojat lokale, duke i fuqizuar ata për të zbatuar praktikatat e certifikimit organik dhe gjurmueshmërisë. Kjo qasje gjithëpërfshirëse forcon konkurrueshmërinë e produkteve shqiptare dhe krijon një bazë për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomive rurale.

Certifikatat e shpërndara në përfundim të trajnimeve shënojnë angazhimin dhe përkushtimin e pjesëmarrësve për të zbatuar standardet globale dhe për të transformuar praktikatat e tyre bujqësore. Kjo nismë shërben si një model për fuqizimin e sektorit bujqësor dhe për përgatitjen e Shqipërisë për të kapërcyer sfidat dhe për të përfituar nga mundësitë që ofron tregu ndërkombëtar.

Përmes kësaj përpjekjeje të përbashkët, Shqipëria vendos bazat për një të ardhme më të ndritur, ku bujqësia organike, gjurmueshmëria dhe inovacioni do të jenë shtyllat kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e mirëqenies në komunitetet rurale.



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



Buxheti i shtetit 2025 dhe kërcënimet nga ngrohja globale e klimës

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Nr. 1 / Nëntor, 2024



Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Kohët e fundit u miratua buxheti për vitin 2025. Ne ende nuk e dimë se sa është rritur buxheti për Emergjencat Civile, por unë mendoj se duhet të jetë një zë buxheti, posaçërisht për të përballuar rreziqet e pritshme nga ngjarjet dëmprurëse të shkaktuara nga ngrohja globale. Të gjithë po e shikojmë me sytë tanë se çfarë po ndodh kudo në Evropë me pasojat e ngrohjes globale.

Ka ardhë koha, që në radhë të parë politikëbërësit dhe vendimmarrësit të dëgjojnë më seriozisht institucionet shkencore. Institucionet shkencore serioze botërore kanë këshilluar politikën botërore që para 40 viteve, për rreziqet që do t'i kanoseshin botës nga ngrohja globale. Këto 10 vitet e fundit, të gjithë jemi ndërgjegjësuar për drejtësinë e këshillimeve të dhëna nga shkenca, port tani bota është në një mendje, se

mbase jemi në një pikë të pakthyeshme për të korrigjuar gabimet e bëra.

Si reagim pozitiv ndaj ngrohjes globale po rriten me shpejtësi disa elemente teknologjike që ecin drejt “Ekonomisë së Gjelbër”

Fushat e ekonomisë që po ecin në drejtimin e duhur janë:

- Shtimi i numrit të makinave elektrike,
- Përdorimi i energjisë diellore,
- Përdorimi i energjisë së erës,
- Teknologji me teknika të larta në menaxhimin e gazit karbonik (CO₂),
- Shtimi i sipërfaqes së bujqësisë biologjike/organike, e cila përdor një pjesë të inputeve, të cilat nuk vijnë nga industria ndotëse prej gazrave serrë të shkatërrimit të shtresës së Ozonit, ku më kryesorët janë: gazi karbonik (CO₂), Metani (CH₄), Oksidi Azotit (NO₂) etj.
- Prodhimi i proteinave dhe yndyrnave me origjinë nga bota bimore dhe kufizimi i kafshëve shtëpiake, sepse blegtoria përdor burime të mëdha uji dhe energjie, etj.

Megjithatë ngjarjet e rënda klimatike do të ndodhin.

Jemi në një kohë, që duhet të bëjmë një kompromis jo shumë të këndshëm mes zhvillimit të shpejtë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Pra në mënyrë figurative, duhet ecur me atë “marsh” që të shmangin aksidentet

klimatike. Shteti duhet parë si një familje. Çdo familje ecën me llogari ekonomike. Nuk synon drejtë luksit të tepruar, por mban edhe një buxhet rezervë për të përballuar vështirësitë që mund të ndodhin.

Ka ardhur koha për një strategji kursimi në të gjitha degët dhe degëzat e ekonomisë. Luksin duhet ta zëvendësojmë vetëm me të nevojshmet dhe të domosdoshmet jetike. Natyra e abuzimeve njëqindveçare të njeriut ndaj saj, po i shpresh me hakmerrije për pak orë.

Ngjarjet e ngrohjes globale po sjellin dëmet që shkaktojnë luftrat me armët moderne, si tanket, raketat, dreonet vrasës.

Në këtë këndvështrim buxheti rezervë duhet të jetë sa ai i mbrojtjes së atdheut.

Pa rezerva monetare nuk ndihmohen dot fermerët e dëmtuar nga kushtet e ngrohjes globale, nuk ndihmojmë dot bizneset e dëmtuara, nuk ndihmojmë dot qytetarët që humbasin shtëpitë nga rreziqet e klimës. Këto ngjarje potenciale negative shkaktojnë kolapse ekonomike. Sistemi i sigurimeve duhet të bëhet me forcën e ligjit.

Ky ligj detyron çdo qytetar dhe biznes që të kursejë për ditët të vështira.

Pra mendoj se duhet të ketë një zë buxheti, “Buxheti i përballimit të rreziqeve të ngrohjes globale të klimës”...

Dëmtimet e bujqësisë nga breshëri



Përmbytjet nga shirat e rrëmbyeshëm



Thatësiat po shtrihen në miliona hektarë



INFORMACIONE

Java Ndërkombëtare e Sipërmarrjes rikthehet në Tiranë

Java Ndërkombëtare e Sipërmarrjes (GEW Albania 2024) rikthehet në Tiranë nga datat 18-25 nëntor, me një sërë aktivitete të rëndësishme ku do të mbledhen së bashku novatorë, sipërmarrës dhe biznese nga shumë vende të botës.

Nën kujdesin e posaçëm të ministres së Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Delina Ibrahimaj së bashku me Agjencinë Shtetërore të Start Up-eve, do të organizohen mbi 50 aktivitete në Tiranë, me mbështetjen e 35 partnerëve nga sektori publik dhe privat, bota akademike dhe organizatat ndërkombëtare që operojnë në vend.

Java Ndërkombëtare e Sipërmarrjes (GEW Albania 2024) do të ketë në fokus rritjen endërveprimit midis të gjithë aktorëve, rrjetëzimin, diversifikimin e financeve alternative, fuqizimin e ekosistemit mbështetës, por mbi të gjitha transformimin e kulturës së të bërit biznes me qasje ndaj risive globale dhe krijimit të vlerës së shtuar për ekonominë.

Në këtë frymë, sesionet që

do të organizohen do të përfshijnë aftësim dhe frymëzim nga histori suksesi sipërmarrjesh kombëtare dhe ndërkombëtare; motivim nga folës dinamik dhe takime me mentorë; programe aftësimi me partnerë të ndryshëm; diskutime me gratë sipërmarrëse, të rinj ambiciozë dhe drejtues biznesesh; diskutime në panele, prezantime dhe raporte të industrive; vizita në biznese dhe takime të dedikuara me drejtues të korporatave të huaja dhe vendase.

Kjo javë do të mbledhë së bashku themelues biznesesh, investitorë, ekspertë dhe entuziastë të sipërmarrjes nga e gjithë bota, duke ofruar mundësi për rrjetëzim, mësim dhe bashkëpunim për zhvillimin e ideve dhe projekteve të reja.

Gjatë javës, qytetarët dhe profesionistët shqiptarë do të kenë mundësinë të marrin pjesë në një seri aktivitete, duke përfshirë seminare, trajnimet, panele diskutimi dhe sesione mentorimi që do të mbahen në disa nga lokacionet më të rëndësishme të Tiranës.

Të gjitha sesionet e kësaj jave synojnë të frymëzojnë,

motivojmë, fuqizojmë, lidhim dhe ndajmë njohuritë në fushën e sipërmarrjes me studentë, studentë sipërmarrës, mentorët dhe partnerët tanë të biznesit.

Shqipëria ka histori të suksesshme sipërmarrjesh të reja dhe po punon për të fuqizuar ekosistemin e tyre, përmes një kuadri ligjor model dhe mbështetjes së vazhdueshme financiare. Misioni ynë është pikërisht zhvillimi i këtij vizioni.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar gjithmonë dhe më shumë në mbështetje të sipërmarrjes novatore dhe përmirësimit të mjedisit ekonomik, përmes aksesit financiar me skemat e granteve, zhvillimit të kapaciteteve të lehtësuesve, si dhe aftësimi të talenteve, duke i shërbyer një qëllimi primar, atij të rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Kjo është një mundësi e shkëlqyer për të kthyer Shqipërinë në një qendër dinamike për inovacion dhe zhvillim ekonomik, duke bashkuar profesionistë dhe liderë të ndryshëm nga e gjithë bota në një javë të mësimi dhe rritjes.

Shqipëria dhe OSBE të përkushtuara për mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e komunitetit

Ambasadori i OSBE-së në Tiranë, Michel Tarran mori pjesë në takimin rajonal “Parandalimi i prerjeve të paligjshme të pyjeve në Malet e Sharrit dhe në zonën e Masivit të Korabit”,

Zyrës së Bashkërenduesit për Veprimtaritë Ekonomike dhe Mjedisore të OSBE-së.

Takimi mbledhi mbi 50 zyrtarë të zonave të mbrojtura, përfaqësues bashkiakë, të poli-

me një biodiversitet të pasur dhe peizazhe që përbëjnë shtyllën kurrizore të sektorit të saj të turizmit dhe të ekonomive vendore. Sot, jemi mbledhur këtu, në rajonin e bukur të Dibrës, brenda zonës së mbrojtur Korab-Koritnik – një rajon i bollshëm me burime natyrore dhe potencial turistik, por i cenueshëm nga rreziqet mjedisore nëse zhvillimi nuk menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme. Si Shqipëria, ashtu edhe OSBE-ja, janë të përkushtuara për ruajtjen e këtyre burimeve nëpërmjet praktikave të qëndrueshme, që mbrojnë mjedisin dhe mirëqenien e komunitetit”, tha Tarran.

Takimi është pjesë e projektit me fonde jashtëbuxhetore “Forcimi i përgjigjeve ndaj rreziqeve të sigurisë nga ndryshimet klimatike në Evropën Juglindore, Evropën Lindore, Kaukazin e Jugut dhe Azinë Qendrore”, i cili zbatohet nga OSBE-ja, në partneritet me “adelfi”.

Fokusi i projektit në Evropën Juglindore janë mali i Sharrit dhe Masivi i Korabit, që përbëhen nga katër zonat e mbrojtura: Korab-Koritnik, Mavrovë, Mali Sharr dhe Sharri/Šara.



së bashku me prefektin e Dibrës, Nexhbedin Shehu dhe ekipin për ndryshimet klimatike të

cisë kufitare dhe organizata të shoqërisë civile. “Shqipëria është e bekuar



Çela takim me ambasadorin Atay: Përafrim i modelit turk të turizmit me atë shqiptar

Transformimi i shpejtë i Shqipërisë në rrugën integruese dhe në mënyrë të veçantë ecuria shumë pozitive e sektorit të turizmit ishin në qendër të takimit që Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Turizmit, Zana Çela zhvilloi me Ambasadorin e Republikës së Turqisë në Shqipëri, Tayyar Kağan Atay.

Drejtoresha e Përgjithshme e AKT-së paraqiti në takim, vizionin afatmesëm dhe afatgjatë të qeverisë shqiptare që shtrihet përtej rritjes së thjeshtë ekonomike, konkretisht në zhvillimin strategjik të turizmit të nivelit të lartë.

Duke patur parasysh edhe shifrat në rritje të turistëve, ku numri vizitorëve nga Turqia i kaloi 300 mijë vetëm në 2024, ambasadori Atay e përgëzoi Shqipërinë për këtë sukses të madh.

“Jemi krenarë për suksesin tuaj. Për një vend me 2.8 milion banorë, tërheqja e një num-

ri 4 herë më të madh sesa numri i popullsisë është një sukses i madh”, theksoi ambasadori turk.

Çela shprehu dëshirën për të konsoliduar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e eksperiencave mes Agjencisë Kombëtare të Turizmit

Ambasadori Atay tregoi vullnetin e plotë për t’u angazhuar në përafrimin e modelit turk të turizmit me atë shqiptar, edhe në kuadër të partneritetit strategjik mes Shqipërisë dhe Turqisë.

Në takim u bisedua edhe mbi kalendarin digjital të ak-



me Agjencinë Turke të Promovimit dhe Zhvillimit të Turizmit.

tiviteteve turistike dhe kulturore që aplikacioni TEA ofron për turistët.

Kumbaro: Rikualifikim ekoparkut të Ulzës dhe ndërtim i qendrës multifunkionale në lumin Vjosa

Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro deklaroi se me buxhetin 2025 investimet e brendshme rriten në masën 19%, ose plus 173 milionë lekë, ku përmendi dy investime kryesore të parashikuara në zonat e mbrojtura.

Në fjalën e saj në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, ku po shqyrtohet në parim projektligji “Për buxhetin e vitit 2025” të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ministrja Kumbaro tha se “investimi i parë është rikualifikimi i ekoparkut të Ulzës, park natyror të cilin në vitin 2022 e dyfishuam në hapësirë, përgatitëm projektin me buxhetin e vitit të kaluar.

Sapo ka filluar puna dhe do të vazhdojë në tre vite me një vlerë 523 milionë lekë”.

“Ju bëj me dije se punimet kanë filluar dhe do të vazhdojnë gjatë sipas parashikimeve të tavaneve të buxhetit afatmesëm”, tha Kumbaro.

Kumbaro tha se investimi tjetër është ndërtimi i qendrës multifunkionale në lumin Vjosa, me një vlerë në total prej 690 milionë lekë, pas shpalljes së Vjosës Park Kombëtar.

“Pas shpalljes së Vjosës Park Kombëtar dhe konkursit kombëtar për të ndërtuar qendrën multifunkionale për Parkun Kombëtar të Vjosës do të ketë 3 vendndodhje. Qendra kryesore në Tepelenë aty ku lidhet Vjosa me lumin Drino, një degë – ante-

në po e quaj, do të jetë në Përmet në pjesën e sipërme të lumit të Vjosës dhe një tjetër antenë në Nartë, Vlorë, ku është një tjetër degëzim në të cilin të kemi një mbulim jo vetëm thjesht për vizitorë, jo thjesht pika informacioni, por jemi duke folur për qendra multifunkionale, për zyra për administratën, laboratorë për kërkime shkencore dhe me muze natyror”, nënvizoi Kumbaro.

Ministrja Kumbaro u shpreh se “të gjitha këto do të shpëgojnë jo vetëm nëpërmjet edukimit, por edhe nëpërmjet informacionit të prezantuar në mënyrë sa reale, aq dhe moderne të gjithë biodiversitetin e florës dhe faunës që, si e kanë quajtur të gjithë shkencëtarët ndërkombëtarë Vjosën, është një laborator natyror i jashtëzakonshëm për faktin se është lumi i vetëm i egër në Evropë, pasi në të gjitha vendet e tjera të Evropës lumenjtë janë ndërhyrë”.

“Kufijtë e Parkut Kombëtar të Vjosës shtrihen nga kufiri me Greqinë ku fillojmë marrim pjesën e asaj që i takon Shq-

ipërisë sepse 70 km e para janë në Greqi, përfshijnë tre lumenjtë: Shushicën, Bëncën e Drinon dhe grykëderdhjen e Vjosës, mes qarkut të Fierit dhe Vlorës, grykëderdhje që ka një mbrojtje të dyfishtë”, tha Kumbaro.

Ministrja Kumbaro bëri të ditur gjithashtu se “kemi miratuar Planin e Integruar të Menaxhimit të Parkut Kombëtar Lumi Vjosa dhe kemi marrë edhe miratimin nga pala gjermane për një grant për të na asistuar në zbatimin e këtij plani me projekte të vogla në territor, ku përfshihen Korça, Gjirokastra, Fieri dhe Vlora”.

“Ne kemi përgatitur edhe dosjen për të aplikuar në UNESCO në kategorinë “Njeriu dhe Biosfera”, një kategori shumë e rëndësishme e trashëgimisë natyrore të UNESO-s. Dosja është pranuar, është në fazën e shqyrtimit kemi opinione pozitive dhe besojmë shumë fort që në 2025 Vjosa do të jetë pjesë e trashëgimisë botërore natyrore e UNESCO”, tha Kumbaro.



Republika Popullor e Kinës, është vendi me potencialin më të lartë ekonomik renditet ndër partnerët kryesorë tregtar me Shqipërinë.

Gjatë viteve të fundit, Kina është zhvilluar në vendin me teknologjik dhe më prodhues bujqësor në botë. Vëllimi i përgjithshëm ekonomik është rritur nga 7.7 miliardë euro në vitin 1952, në 15 trilon euro në vitin 2022.

Vitet e fundit marrëdhëniet e Shqipëri- Kinë kanë shënuar një intensifikim të marrëdhënieve ekonomike tregtare.

Shqipëria ka qenë përfutuese e disa projekteve nga qeveria kineze edhe pse me ndihma modeste ato kanë qenë të rëndësishme dhe kanë luajtur një rol të rëndësishëm në sektorët ku janë adresuar si në shkolla, bujqësi apo strukturën digjitale.

Kina është një nga vendet kryesore me të cilat Shqipëria ka bashkëpunim për shkëmbimet tregtare si eksporte dhe importet.

Bizneset shqiptare ndërkohë janë shumë të angazhuara dhe po shtojnë interesin për produktet kineze, sidomos tek ato që i përkasim artikujve elektronik, pajisje hidrosanitare që zënë gati 55% të volumit të përgjithshëm të importeve kineze në Shqipëri.

Referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, sasia e importeve kineze përkthehet në 59 miliardë lekë ndërsa eksportet shqiptare drejt Kinës kapin vlerën 37 milionë lekë. Kjo do të thotë se bashkëpunimi i bizneseve mes të dy vendeve Shqipëri –Kinë ka shumë potencial për tu zhvilluar ende më shumë në periudhën në vijim.

Nga ana tjetër angazhimi i qeverive dhe bizneseve për nxitjen e bashkëpunimit Shqipëri-Kinë ka zënë vend të rëndësishëm edhe në Unionin e Investimeve të Ballkanit Perëndimor, ku shënohen statistika të rëndësishme të këtij bashkëpunimi.

Duke i referuar të dhënave të fundit të shkëmbimeve tregtare Shqipëri - Kinë për vitin 2023, rezulton se ka pasur një rritje të ndjeshme jo vetëm me bazë vjetore por edhe me vitet e mëparshme.

Treguesi në rritje i shkëmbimeve tregtare ka kapur shifrën e 1 miliardë eurove, kjo shifër i afrohet viteve 2003 apo 2005 të cilat janë vitet ku shënohen edhe treguesit më të

Shqipëri-Kinë, bashkëpunim në rritje dhe tregje të reja eksplorimi në shkëmbimet tregtare

lartë të shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve.

Sipas Institutit të Statistikave INSTA, në vitin 2017, eksportet shqiptare drejt Kinës thuajse u dyfishuan.

Gjatë muajit janar 2017 eksportet arritën në vlerën e 601 milionë lekëve, ndërsa në janar të 2016-s vlera e eksporteve ishte 363 milionë lekë. Ndërsa importet, bëhet e ditur nga statistikat, llogariten 3.361 milionë lekë me një ulje të lehtë krahasuar me janarin e vitit 2016 kur u importuan 3.421 milionë lekë mallra.

Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave 7.1 % e vëllimit tregtar në vitin 2016 u krye me Kinën. INSTAT bën të ditur gjithashtu se në 2016-ën importet nga Kina u rritën 8.8 % krahasuar me 2015-ën.

Në vlerë importet në vitin 2016 arritën në 50.652 milionë lekë, nga 46.567 milionë lekë që rezultojnë në 2015-ën. Ndërsa sa i përket eksporteve në vlerë, ato llogariten 7.452 milionë lekë në 2016-ën, nga 6.570 që ishin një vit më parë.

Referuar strukturës së mallrave nga Kina importohen makineri, pajisje, pjesë këmbimi, materiale ndërtimi, metale, si dhe tekstile dhe këpucë. Ndërsa eksportohen kryesisht minerale.

Ndërkohë po sipas INSTAT, referuar vitit 2021 Shkëmbimet tregtare Shqipëri –Kinë kanë pasur luhatje në krahasim me vitin e kaluar për sa i përket eksporteve të cilat kanë pësuar një rënie prej 77.8%.

Eksportet për periudhën shtator 2018 janë 243 milionë lekë në krahasim me 1.094 miliardë lekë në shtator të 2017. Pra, janë ulur me 851 milionë lekë. Importet nga ana tjetër, këtë shtator janë 4.283 miliardë lekë në krahasim më 3.959 miliardë lekë në shtator 2017. Pra, kanë pësuar një rritje prej 324 milionë lekë ose 8.2 %.

Për sa i përket importeve sipas grup-mallrave konstatohet një rritje në mallrat si: “Ushqim, pije duhan, Lëkurë dhe artikuj prej lëkure, Prodhime druri dhe letre, Materiale ndërtimi metale dhe Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” dhe një ulje në mallrat si: Minerale, lëndë djegëse, Produkte

kimike dhe plastike, Prodhime druri dhe letre dhe Tekstile dhe këpucë”.

Në vitin 2023, eksportet shqiptare drejt Kinës shënuan rënie me gati 50 % gjatë pesëmuajorit të parë të këtij viti krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Instituti i Statistikave (INSTAT) raportoi se në 5-mujorin e këtij viti eksportet e



mallrave shqiptare drejt Kinës llogariten në vlerë 3.2 miliardë lekë, nga 6 miliardë lekë të eksportuara në 5-mujorin e 2022-shit.

Ndërkohë, importet e mallrave, referuar INSTAT, arritën vlerën 37.6 miliardë lekë. Në të njëjtën periudhë të 2022-shit u importuan 27.4 miliardë lekë mallra.

Shqipëria importon nga Kina në këtë periudhë makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi vlera e të cilave gjatë këtij 5-mujori llogaritet 19.5 miliardë lekë. Po ashtu tekstile dhe këpucë, me vlerë gati 4.9 miliardë lekë, produkte kimike e plastike me vlerën mbi 3.2 miliardë lekë dhe dhe materiale ndërtimi e metale me vlerë 5.2 miliardë lekë.

Ndërsa në vitin 2024, eksportet shqiptare drejt Kinës shënuan rritje me 25 % gjatë gjashtëmuajorit të parë të këtij viti krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Instituti i Statistikave (INSTAT) raportoi se në 6-mujorin e e parë 2024 eksportet e mallrave shqiptare drejt Kinës llogariten në vlerë 5.3 miliardë lekë, nga 4.2 miliardë lekë të eksportuara në 6-mujorin e 2023-shit.

Ndërkohë, importet e mallrave, referuar INSTAT, arritën vlerën 42.4 miliardë lekë. Në të njëjtën periudhë të 2023-shit u importuan 46.7 miliardë

lekë mallra.

Shqipëria eksporton drejt Kinës kryesisht minerale, ndërsa importon makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi vlera e të cilave gjatë këtij 6-mujori llogaritet 20.4 miliardë lekë.

Po ashtu tekstile dhe këpucë, me vlerë gati 4.9 miliardë lekë, produkte kimike e plastike me vlerën mbi 6.5 miliardë lekë dhe dhe materi-



ale ndërtimi e metale me vlerë 5.9 miliardë lekë.

Shkëmbimet tregtare mes Shqipërisë dhe Kinës janë në rritje, me një histori të gjatë bashkëpunimi. Shqipëria vlerëson fuqinë ekonomike të Kinës dhe ka potencial për të zhvilluar më tej bashkëpunimin. Investimet kineze në Shqipëri janë të inkurajues, ndërsa mundësitë për të rritur bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar janë të shumta. Sfidat për të arritur më shumë dhe për të shfrytëzuar më mirë mundësitë e bashkëpunimit vazhdon.

Në kuadrin e bashkëpunimit të ngushtë mes dy vendeve, ekspertët vlerësojnë me rëndësi Projektin e Kinës për rrugën e Mëndafshit.

Projekti i Kinës për rrugën e Mëndafshit është një Projekt Rajonal, që nuk prek vende individuale por ideja është për të identifikuar ato segmente rajonale që mund të mbështeteshin për tu integruar më pas në rrjetin e korridoreve të projektuar të transportit.

Shqipëria edhe për arsye gjeopolitike, e konsideron këtë projekt me vlera të konsiderueshme.

Në vitet 1960 -1970 Kina dhe Shqipëria krijuan së bashku një kapitull miqësie që po zhvillohen edhe me angazhimin e bizneseve të të dy vendeve.

Vitet e fundit marrëdhëniet Shqipëri-Kinë kanë ruajtur një vrull të mirë zhvillimi mes të të dy vendeve, që përballen me mundësi të mira bashkëpunimi në kuadër të Nismës Një Brez Një Rugë dhe mekanizmit të bashkëpunimit Kinë vendet e Europës Qendrore dhe Lindore. Shkëmbimet tregtare Shqipëri Kinë diversifikohen në fushën e Bujqësisë dhe Ushqimit

Vitet e fundit eksportet e Shqipërisë drejt Kinës kanë qenë të diversifikuara edhe në drejtim të sektorit të bujqësisë. Majlta made in Albania dhe produkte të tjera shqiptare si qumështi e vaji i ullirit kanë hyrë në tregun kinez dhe grupi i parë i mjaltit shqiptar në tregun kinez është eksportuar tashmë në Kinë.

Marrëdhëniet tregtare midis anëtarëve të shoqatave të Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH) dhe subjekteve tregtare nga Republika Popullore e Kinës janë të hershme, të qëndrueshme, pavarësisht largësisë, konsiderohen reciprokisht dobiprurë dhe vlerësohen shumë korrekte.

Në vitin 2022, shoqatat e KASH-it dhe anëtarët e saj intensifikojnë bashkëpunimin me autoritet kineze të interesuara të vijnë në importojnë nga Kina traktorë e mjete të mekanikës bujqësore të prodhuara me teknologji bashkëkohore, pjesë ndërimi, linja të agropëpunimit.

Gjithashtu interesi i bashkëpunimit shtrihet edhe në fushën e asistencës, përvojës dhe teknologjisë bashkëkohore për përpunimin e mbetjeve organike dhe përmirësimin e mjedisit në zonat rurale.

Anëtarët e shoqatave të KASH shprehin interes dhe po punojnë të eksportojnë në Republikën Popullore të Kinës Ullinj dhe Vaj ulliri cilësor, mjalt, bimë mjekësore e aromatike, pije si verë, konjak dhe raki, agrume, arra, lajthi dhe bajame etj.

Gjithashtu në fokus të bashkëpunimit ka qenë edhe importi i traktorëve, makinerive e mjeteve bujqësore nga Kina, që zë një peshë

të rëndësishme në parkun e mjeteve bujqësore.

Vite më parë përmes një kredie nga Republika Popullore e Kinës, është importuar njëherësh 2000 traktorë të rinj, për të rinovuar parkun e mjeteve bujqësore, që është sasia më e madhe e importuar në një kontratë. Gjithashtu fakt është se importi i traktorëve nga Kina prej sektorit privat nuk është ndërprerë asnjëherë.

Në këtë kohë Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Kinës dhe Ambasada e Kinës në Tiranë kontribuan duke i dhënë shoqatës AVALB në Cërrik, një grant për furnizimin me mjete të mekanikës bujqësore. Nisma për rinovimin e parkut të traktorëve dhe mjeteve bujqësore pritet të vazhdojë edhe në zona të tjera të vendit në këtë sektor.

Të gjitha këto i kanë dhënë një shtytës bashkëpunimit tregtarë Shqipëri Kinë.

Dy vendet kanë gjetur gjuhën e përbashkët për të forcuar më tej bashkëpunimin dhe në mënyrë më të strukturuar.

